VENDIM
Nr. 9, datë 15.1.2014

PËR RREGULLIMIN E DISA ÇËSHTJEVE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 170/2013, DATË 14.11.2013 "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ASISTENCËS SË SHËRBIMIT DOGANOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "g" dhe "gj", të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 170/2013, datë 14.11.2013 "Për miratimin e marrëveshjes së asistencës së shërbimit doganor", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rregullimin e disa çështjeve në zbatim të ligjit nr. 170/2013, datë 14.11.2013 "Për miratimin e marrëveshjes së asistencës së shërbimit doganor", sipas shtojcave "A", "B", "C", "D", "I", "E", "F", "K" dhe "L", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, përkatësisht:

a) Shërbimet dhe pajisjet që do të furnizohen nga kontraktuesi, përcaktuar në shtojcën "A";

b) Zyrat, pajisjet teknike dhe infrastruktura që i nevojitet kontraktuesit, përcaktuar në shtojcën "B";

c) Plani i pagesave dhe i mbajtjeve nga pagesat, si dhe formati dhe rregullat e rishikimeve tremujore të treguesve kryesorë të performancës, përcaktuar në shtojcat "C" dhe "I";

ç) Modeli i letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të kontraktuesit, përcaktuar në shtojcën "D";

d) Përshkrimi i punës së kontraktuesit, përcaktuar në shtojcën "E";

dh) Modeli i garancisë së paradhënies në favor të autoritetit kontraktues, përcaktuar në shtojcën "F";

e) Miratimi i njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës për vitin e tretë, përcaktuar në shtojcën "K";

ë) Miratimi i modelit të letrës së konfirmuar e të transferueshme të gatshme të kredisë në favor të kontraktuesit për automjetet, përcaktuar në shtojcën "L".

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shtojcat e përcaktuara në shkronjat "a" - "ë", të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen pjesë përbërëse e marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 170/2013, datë 14.11.2013.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA A
SHËRBIMET DHE PAJISJET QË DO TË FURNIZOHEN NGA KONTRAKTUESI

Burimet njerëzore	**Viti i 1-rë dhe i 2-të**	**Viti i 3-të***
1 x Drejtor programi	26 muaj	12 muaj
1 x Ekspert për burimet njerëzore (HR) për doganat	23 muaj	12 muaj
1 x Ekspert antikorrupsioni për doganat	23 muaj	12 muaj
1 x Ekspert për administrimin e riskut për doganat	23 muaj	12 muaj
1 x Menaxher operacionesh	24 muaj	12 muaj

1 x Auditues operacionesh	24 muaj	12 muaj
9 x Këshilltarë operacionesh	212 muaj	108 muaj
Ekspertë afatshkurtër	10 muaj	4 muaj

* Në rast të dhënies nga Autoriteti Kontraktues të njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës (viti i 3-të) Kontraktuesit në përputhje me nenin 2.3.2 të kontratës.

Pajisjet për personelin e Kontraktuesit

10 x Sete veglash pune

Çelës anglez
Kaçavida
Elektrikë dore
Pasqyra
Pinca
Leva

35 x Uniforma

Këmisha
Pantallona
Xhaketa
Veshje dimri
Çizme
Helmetë/kapela

11 x Pajisje TIK (të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit)

Laptop
Telefona
Facilitete për rrjete të sigurta
Software për shkëmbim informacioni

Aktivitetet

Zhvillimi i Sistemit BN (HR) të Doganave

- Shqyrtimi i aktiviteteve të ndërmarra nga personeli i Administratës së Doganave sipas funksioneve, pozicioneve dhe vendndodhjes;

- Identifikimi i kompetencave kryesore të kërkuara për secilin prej funksioneve kryesore doganore, bazuar në kuadrin e ri të BE-së për personelin e doganor;

- Shqyrtim dhe rekomandime për përmirësimin e procesit të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit doganor;

- Trajnime për të rritur aftësitë e personelit.

Zhvillimi i Sistemit të Administrimit të Riskut të Doganave

- Rishikimi i profileve ekzistuese të riskut në koordinim të ngushtë me punën ekzistuese që ndërmerret në projektet e BE-së që asistojnë aktualisht në këtë fushë;

- Zhvillimi dhe rritja e profileve të riskut, bazuar në informacionin e dhënë nga grupet operacionale të doganave;

- Mbështetja për zbatimin e profileve të zhvilluara dhe tërësisë së strategjive për menaxhimin e riskut nëpërmjet grupeve operacionale.

Zhvillimi i Sistemit të Antikorrupsionit të Doganave

- Përfundimi i Kodit të ri të Etikës së Doganave;

- Përhapja e Kodit të ri të Etikës;

- Zhvillimi dhe përmirësimi i procedurave dhe i metodologjive të hetimit të brendshëm;

- Mbështetja për zhvillimin e një sistemi për denoncime, që do të mbështesë raportimin e brendshëm të rasteve të korrupsionit dhe të keqadministrimit brenda shërbimeve doganore;

- Rritja e kontakteve me biznesin dhe grupet e interesit nëpërmjet takimeve dhe workshop-eve, si dhe fushatave sensibilizuese për denoncimin e korrupsionit.

Operacionet doganore

- Rishikimi dhe përmirësimi i planifikimit, metodologjisë, eficiencës dhe vlerësimit të operacioneve

doganore (ndalime, kontroll, inspektim dokumentacioni, marrja në pyetje e tregtarëve);

- Mobilizimi dhe ngritja e 8 grupeve operacionale, kryesuar nga punonjës të zgjedhur të doganave, asistuar nga CA-ja;

- Përmirësim në identifikimin e nënvlerësimit, përshkrimit të gabuar, kontrabandës dhe shkeljeve të tjera;

- Përcaktimi i humbjeve të mundshme të të ardhurave;

- Identifikimi i pikave të dobëta të sistemit dhe të izoluara në veprimet e doganave.

SHTOJCA B
ZYRAT, PAJISJET TEKNIKE DHE MJETE TË TJERA QË DO TË SIGUROHEN NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

1. Akomodimi në zyra të përshtatshme për personelin e Kontraktuesit (këshilltarët e doganave).

2. Mobilie të përshtatshme zyre dhe pajisje për personelin e Kontraktuesit (këshilltarët e doganave).

3. *Regjistrimin, taksat dhe siguracionin e 10 automjeteve të livruara dhe siguruara nga Kontraktuesi në përputhje me nenin 6.1.4.

4. Karburant të përshtatshëm, mirëmbajtje (siç kërkohet në bazë të garancisë së prodhuesit) dhe shpenzimet për përdorimin e automjeteve.

5. Të sigurojë parkim dhe garazh të përshtatshëm për automjetet.

6. Masa sigurie të përshtatshme për ekipin operacional të Kontraktuesit.

*I) Në përputhje me nenin 6.1.4 të kontratës, 10 automjetet do të qëndrojnë në pronësinë, regjistrimin dhe administrimin e përditshëm të Kontraktuesit, deri në përfundim apo mbarim të afatit të kontratës. Personeli i Administratës Doganore ose Autoriteti Kontraktues mund t'i drejtojë apo përdorë secilin prej këtyre 10 automjeteve me autorizimin paraprak të Kontraktuesit.

II) Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë se: i) vendndodhja e Administratës Doganore është në çdo kohë një mjedis i sigurt, në të cilin personeli i Kontraktuesit mund të drejtojë (apo të udhëtojë si pasagjer në të) secilin prej këtyre 10 automjeteve; dhe ii) secili person (i ndryshëm prej personelit të Kontraktuesit) që drejton njërin nga këto 10 automjete, e bën në mënyrë profesionale, të sigurt dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar.

III) Do të zhdëmtojë Kontraktuesin ndaj çdo përgjegjësie, kostoje, shpenzimi, dëmi dhe humbjeje (përfshirë, po pa u kufizuar në gjoba dhe kosto ligjore dhe kosto e shpenzime të tjera profesionale) të pësuara apo të ndeshura nga Kontraktuesi, të ngritura në lidhje apo jo me: i) shkeljet apo me veprimet, apo mosveprimet e kryera me neglizhencë nga ana e Autoritetit Kontraktues, në lidhje me shtojcën B; dhe ii) çdo pretendimi ndaj Kontraktuesit, i bërë nga palët e treta për vdekje, lëndime trupore, dëmtim të pronës apo për çfarëdo përgjegjësie, kosto, shpenzimi, dëmi dhe humbje të tjera, të cilat rrjedhin apo jo nga përdorimi i këtyre 10 automjeteve nga çdo person (përveç personelit të Kontraktuesit), përfshirë çdo punëtor, kontrator, nënkontrator apo agjent të Autoritetit Kontraktues apo administratës doganore.

IV) Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kosto apo shpenzime në lidhje me pikat 3, 4 apo/dhe 5 të përmendura më sipër në lidhje me këto 10 automjete (për shembull, nëse Kontraktuesi, në cilësinë e pronarit, regjistron taksat dhe siguron 10 automjetet), Autoriteti Kontraktues do të rimbursojë Kontraktuesin për koston dhe shpenzimet e tilla.

V) Kontraktuesi do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues një faturë mujore, ku do të listojë: i) çdo kosto dhe shpenzim të referuar në paragrafin (IV); dhe ii) çdo shumë si kompensim nga paragrafi (III) i shtojcës B, dhe Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesat te Kontraktuesi brenda një afati prej maksimumi 30 (tridhjetë) ditësh nga data e lëshimit të faturës nga Kontraktuesi. Për shmangien e çdo dyshimi, pagesat e këtyre faturave mujore do të sigurohen nga letër krediti të gatshme të transferueshme sipas nenit 6.1.3 dhe shtojcës D të kësaj kontrate dhe/apo përmes letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë në dobi të Kontraktuesit (shërbimet)

të referuar në nenin 6.1.3 dhe shtojcën L të kësaj kontrate. Për shmangien e çdo dyshimi, kostot dhe shpenzimet dhe çdo shumë, pasojë e dëmshpërblimit referuar në paragrafin (V), janë në shtesë të 400.000 eurove të referuara në nenin 6.1.4 të kontratës.

Marrëveshje e versionit të detajuar të shtojcës B

a) Gjatë periudhës 2-mujore të fazës së mobilizimit të kontratës, Kontraktuesi do të përgatisë një version më të detajuar të shtojcës B, duke përshkruar më me detaje pikat 1-6 më sipër (duke përfshirë, por jo vetëm, bërjen, modelin, përmasat, zonën dhe vendndodhjet për parkim të sigurt (ditë dhe natë), procedurat e furnizimit me karburant për të 10-ta automjetet, procedura për dorëzimin e 10 automjeteve në fund të kontratës).

b) Autoriteti Kontraktues do të ofrojë dhe do të sigurojë që edhe KMP-ja të ofrojë të gjithë asistencën, bashkëpunimin dhe informacionin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Kontraktuesi për të përgatitur një version të detajuar të shtojcës B.

c) Kontraktuesi do t'i dorëzojë versionin e detajuar të shtojcës B (të nënshkruar rregullisht nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit), kryetarit të KMP-së për ta rishikuar. Brenda 10 ditëve nga marrja e versionit të detajuar të shtojcës B nga kryetari i KMP-së, Autoriteti Kontraktues do të evidentojë pranimin e versionit të detajuar të shtojcës B, duke siguruar që kryetari i KMP-së të kundërnënshkruajë versionin e detajuar të shtojcës B dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit (ku do të bihet dakord të zëvendësojë "shtojcën B" për qëllimet e kontratës). Autoriteti Kontraktues nuk duhet të refuzojë, të pranojë ose të vonojë pranimin e versionit të detajuar të shtojcës B në mënyrë të paarsyeshme. Në qoftë se kryetari i KMP-së nuk njofton Kontraktuesin me shkrim për refuzimin e versionit të detajuar të shtojcës B (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda 10 ditëve nga marrja nga kryetari i KMP-së të versionit të detajuar të shtojcës B, versioni i detajuar i shtojcës B do të konsiderohet sikur është pranuar nga Autoriteti Kontraktues për çdo qëllim të tij. Çdo mosmarrëveshje midis palëve, në lidhje me pranimin ose refuzimin e versionit të detajuar të shtojcës B, do të zgjidhet në përputhje me nenin 10 të kësaj kontrate.

SHTOJCA C
PËRCAKTIMI I PLANIT TË PAGESAVE DHE MBAJTJET NGA PAGESA
SEKSIONI 1
PLANI I PAGESAVE (EURO)

1	2	3	4	5	6	7	8
Muaji	**Parapagesa**	**Pagesa mujore**	**Zbritjet nga të ardhurat mujore të synuara**	**Zbritjet mujore të performancës**	**Zbritjet nga pragu mujor**	**Pagesa e zbritjeve objekt i TKP-ve të pranuara**	**Totali**
	820,222						820,222
1	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	-13,199	0	241.598
2	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13,199	0	241.598
3	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13,199	0	241.598
4	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
5	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
6	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
7	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	237,584	479.181
8	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
9	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
10	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	39,597	281.194
11	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598

12	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
13	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	514,766	756.363
14	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
15	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
16	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	39,597	281.194
17	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
18	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
19	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	197,987	439.584
20	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
21	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241.598
22	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	39,597	281,194
23	-34,176	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241,598
24	-34,174	341,760	-26,398	-26,398	13.199	0	241,598
	0	0	0	0	0	514,766	514,532
Vlera e përgjithshme e kontratës (24 m)	**0**	**8.202.228**	**633.552**	**633,540**	**316.776**	**1.583.894**	**8.202.228**

Viti i 3-të Zgjatja* (*Në rast të dhënies nga Autoriteti Kontraktues të njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës Kontraktuesit në përputhje me nenin 2.3.2 të kontratës. **Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi do të përdorin përpjekjet e tyre të arsyeshme për të rënë dakord (brenda 20 ditëve nga data e marrjes nga Autoriteti Kontraktues i njoftimit të zgjatjes (viti i 3-të) bazuar në performancën e Kontraktuesit në vitin e 1-rë dhe vitin e 2-të, duke referuar në arritjet e TKP-ve të pranuara. Kjo marrëveshje nuk mund të refuzohet pa arsye apo të vonohet nga secila prej palëve dhe do të regjistrohet me shkrim në formën e shtojcës C të rishikuar, seksioni 1 (plani i pagesave) dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Autoritetit Kontraktues dhe nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit, dhe do të konsiderohet të jetë pjesë e kontratës.

25	-0	341,756	Do të bihet dakord**	Do të bihet dakord **	Do të bihet dakord **	Do të bihet dakord **	341.756
26	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
27	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
28	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
29	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
30	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
31	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
32	-0	341,756	Do të bihet	Do të	Do të bihet	Do të bihet	341.756

			dakord	bihet dakord	dakord	dakord	
33	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
34	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
35	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
36	-0	341,756	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	Do të bihet dakord	341.756
		0					0
Vlera e përgjithshme e kontratës, Viti i 3-të Zgjatje	**0**	**4.101.072**					**4.101.072**

SEKSIONI 2
ZBRITJET DHE TKP-të E PRANUARA

1. Zbritjet

Zbritjet e mëposhtme do të mundësohen prej pagesave mujore të Kontraktuesit, të përcaktuara në kolonën 3 të planit të pagesave në seksionin 1 të shtojcës C dhe do të mbahen nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të seksionit 2 të shtojcës C:

I) Një zbritje mujore siç përcaktohet në kolonën 4 të planit të pagesave ("Zbritjet nga të ardhurat mujore të synuara" ose "ZAMS")
II) Një zbritje mujore siç përcaktohet në kolonën 5 të planit të pagesave ("Zbritjet mujore të performancës" ose "ZMP")
III) Një zbritje mujore siç përcaktohet në kolonën 6 të planit të pagesave ("Zbritjet nga pragu mujor" ose "ZPM")

2. Shqyrtimi i TKP-ve të pranuara tremujore

2.1 ZMAS-të, ZMP-të dhe ZPM-të do të mbahen nga Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit nëse (apo në çfarë mase) Kontraktuesi ka arritur TKP-të e pranuara në pjesën I, pjesën II dhe në pjesën III të TKP-ve të pranuara përkatësisht, e cila do të ndodhë brenda 10 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori gjatë kohëzgjatjes së kontratës (të gjitha siç janë përcaktuar në planin e shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore në seksionin 3 të shtojcës C) (shqyrtimi i TKP-ve të pranuara tremujore), me kusht që shqyrtimi i parë i TKP-ve të pranuara tremujore do të ndodhë brenda 10 ditëve nga përfundimi i një periudhe 6-mujore nga data e fillimit të shërbimeve dhe do të përfshijë dy tremujorët e parë.

2.2 Përpara shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore, Kontraktuesi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë kryetarit të KMP-së një raport të shkruar, ku do të konfirmohet: i) nëse (apo në çfarë mase) Kontraktuesi ka arritur TKP-në e pranuar (për secilën nga pjesa 1, pjesa 2 dhe pjesa III) në tremujorin(ët) e mëparshëm; dhe ii) në qoftë se jo (qoftë plotësisht ose pjesërisht në lidhje me çdo TKP të pranuar), arsyet pse këto TKP të pranuara nuk janë arritur, qoftë plotësisht ose pjesërisht; dhe iii) një përmbushje shtesë ose alternative, të cilën e ka dorëzuar Kontraktuesi dhe justifikon në mënyrë të arsyeshme pagesën e zbritjes(eve) specifike (Raporti i shqyrtimit të TKP-

ve të pranuara tremujore). Raporti i shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore do të nënshkruhet rregullisht nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit dhe do të shoqërohet me një faturë nga Kontraktuesi në shumën e ZMAS-ve, ZMP-ve dhe ZPM-ve, ose pjesën e tyre *pro rata,* siç mund ta vendosë Kontraktuesi se është e pagueshme ndaj Kontraktuesit, duke iu referuar TKP-ve të pranuara, të cilat Kontraktuesi i ka arritur qoftë plotësisht ose pjesërisht dhe parashikimeve të seksionit 2 të shtojcës C.

2.3 Në qoftë se në tremujorin përkatës: i) Kontraktuesi ka arritur të gjitha ose një pjesë të TKP-ve të pranuara (në pjesën I, pjesën II ose pjesën III); ose ii) çdo mosarritje nga Kontraktuesi i të gjitha ose një pjese të përcaktuar të TKP-ve të pranuara është shkaktuar nga forcë madhore ose për arsye se Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate (vetëm si shembull, parashikimet mbi furnizimin e automjeteve në shtojcën B); ose iii) Kontraktuesi ka dorëzuar një dorëzim(e) shtesë ose alternativ që do të justifikonin në mënyrë të arsyeshme pagesën e mbajtjes(eve) përkatëse, atëherë Autoriteti Kontraktues është i detyruar të pranojë raportin e shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore, duke bërë të mundur që kryetari i KMP-së të kundërnënshkruajë pjesën përkatëse të raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit brenda një afati 10-ditor nga marrja e raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore. Në qoftë se kryetari i KMP-së nuk njofton me shkrim Kontraktuesin për refuzimin e raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit), brenda 10 ditëve pas datës së marrjes nga kryetari i KMP-së të raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore, për të gjitha qëllimet ai do të konsiderohet sikur është pranuar nga Autoriteti Kontraktues. Pas pranimit aktual ose të konsideruar si i tillë të raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me paragrafin 2.3 (ose në rast mosmarrëveshje, atëherë në datën e vendimit të arbitrazhit në favor të Kontraktuesit, të marrë në përputhje me nenin 10 të kontratës), mbajtja(et) përkatëse për tremujorin(ët) e mëparshëm do të bëhen të pagueshme dhe duhet t'i paguhen Kontraktuesit në përputhje me faturën përkatëse të Kontraktuesit brenda 30 ditëve nga data përkatëse e faturës së Kontraktuesit.

2.4 Çdo refuzim nga kryetari i KMP-së i raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore (pjesërisht ose plotësisht) duhet t'i njoftohet Kontraktuesit me shkrim (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda një afati 10-ditor pas datës së marrjes së raportit nga kryetari i KMP-së. Në rast refuzimi, Kontraktuesi ka të drejtë të ndryshojë raportin e shqyrtimit të KMP-ve të pranuara tremujore dhe ta dorëzojë atë rishtazi të kryetari i KMP-së për një përsëritje të procedurave të rishikimit sipas nenit 2.2 dhe 2.3. Çdo mosmarrëveshje mes palëve, në lidhje me raportin e shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore ose miratimin apo refuzimin e raportit të shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore, do të zgjidhet në përputhje me nenin 10 të kontratës.

2.5 Për të shmangur çdo dyshim, në qoftë se ndonjë prej TKP-ve në pjesën III nuk është arritur për çfarëdolloj arsye në çdonjërin prej tremujorëve, Kontraktuesi ka të drejtë të përfshijë arritjet vijuese të pjesës III të TKP-ve (Milestone) në raportet e shqyrtimit të TKP-ve të pranuara tremujore pasardhëse, në mënyrë që të marrë pagesën për çdonjërën prej ZPM-ve.

2.6 Për qëllimet e këtij seksioni 2:

i) Një "Dorëzim(e) alternative ose shtesë" është një dorëzim(e) alternative ose shtesë, të cilat Kontraktuesi i ka dorëzuar për përfitim të Autoritetit Kontraktues dhe të cilat do të justifikonin në mënyrë të arsyeshme pagesën e mbajtjes(eve) përkatëse;

ii) Tremujor nënkupton një periudhë prej 3 muajsh kalendarikë, të llogaritur nga data e fillimit të shërbimit; dhe

iii) Një vit nënkupton një periudhë prej 12 muajsh kalendarikë, duke u llogaritur nga data e fillimit të shërbimit.

3.A TKP-të e pranuara

3.A.1 Palët do të përdorin përpjekjet e tyre të arsyeshme për të rënë dakord dhe nënshkruar TKP-të e pranuara (pjesa I, pjesa II, pjesa III dhe pjesa IV) brenda 1 muaji nga data e

fillimit të shërbimeve në përputhje me procedurën e mëposhtme. Kontraktuesi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë kryetarit të KMP-së një draft të TKP-ve të pranuara (pjesa I, pjesa II, pjesa III dhe pjesa IV) kryesisht në formatin e përcaktuar në shtojcën I, me treguesit e matshëm dhe informacionit bazë në kolonën 7 kompletuar sipas zbatimit, nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit. Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që KMP-ja do të ofrojë të gjithë ndihmën, bashkëpunimin dhe informimin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Kontraktuesi për të përgatitur projektin e TKP-ve të pranuara.

3.A.2 Autoriteti Kontraktues do të regjistrojë pranimin nga ana e tij të draftit të TKP-ve të pranuara, duke bërë të mundur që kryetari i KMP-së të nënshkruajë draftin e TKP-ve të pranuara dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit (ku ai do të bëhet i njohur si "TKP-të e pranuara"). Autoriteti Kontraktues nuk do të refuzojë, të pranojë ose të vonojë në mënyrë të paarsyeshme pranimin e projektit të TKP-ve të pranuara. Kryetari i KMP-së nuk njofton Kontraktuesin me shkrim për refuzimin e draftit të TKP-ve të pranuara (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda një periudhe prej 10 ditësh, pas marrjes së draftit të TKP-ve të pranuara nga ana e kryetarit të KMP-së, ai do të konsiderohet i pranuar nga Autoriteti Kontraktues për të gjitha qëllimet. Çdo mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me pranimin apo refuzimin e draftit të TKP-ve të pranuara, do të zgjidhet në përputhje me nenin 10 të kontratës.

3.A.3 Në rast se projekti i TKP-ve të pranuara nuk është nënshkruar nga palët ose konsiderohet i pranuar nga palët në përputhje me paragrafin 3.A.2 më sipër, brenda 1 muaji nga data e fillimit të shërbimeve për çfarëdo arsye (përfshirë, por pa u kufizuar, si rezultat i një zgjidhje mosmarrëveshjeje në proces në përputhje me nenin 10 të kontratës), Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë më të drejtë të mbajë ose ZAMS-të, ZMP-të ose ZPM-të nga çdo pagesë mujore për Kontraktuesin, të cilat do të bëhen të pagueshme në mënyrë të plotë për Kontraktuesin mbi bazë mujore, pavarësisht nga ndonjë afat tjetër i kësaj kontrate. Në rrethana të tilla, ZMP-të, ZAMS-të dhe ZPM-të e muajit të parë do të bëhen të pagueshme për Kontraktuesin 1 muaj pas datës së fillimit të shërbimeve dhe Kontraktuesi do të ketë të drejtë të faturojë Autoritetin Kontraktues, dhe për të gjitha MPR-të, ZAMS-të dhe MMR-të e mëtejshme, dhe si të tillë deri në datën që drafti i TKP-ve të pranuara është nënshkruar nga palët, këto fatura janë të pagueshme brenda 30 ditëve nga data e faturës(ave) përkatëse të marrë(a) nga Autoriteti Kontraktues.

3.B Rishikimet vjetore të TKP-ve të pranuara

3.B.1 Palët do të përdorin përpjekjet e tyre të arsyeshme për të rënë dakord dhe nënshkruar versionin e rishikuar të TKP-ve të pranuara (vetëm pjesa I dhe pjesa III do të rishikohen), brenda 1 muaji nga rishikimi i TKP-ve të miratuara tremujore në vitin e 1/T3 dhe vitin e 2/T3 në përputhje me procedurën në vijim. Kontraktuesi do të përgatisë dhe do të dorëzojë te kryetari i KMP-së një projekt të TKP-ve të pranuara të rishikuara (pjesa I, pjesa II, pjesa III dhe pjesa IV) me treguesit matës dhe informacionin bazë në kolonën 7 në lidhje me pjesën I dhe pjesën III të TKP-ve të rishikuara sipas rastit, e nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit. Synimi për rritjen e të ardhurave doganore në pjesën I të TKP-së së pranuar do të rishikohet duke marrë parasysh çdo ndryshim thelbësor në regjimin tatimor të zbatueshëm (duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndryshimet në nivelet tatimore bazë, ndryshime në qëllimin e taksave të mbledhura nga administrata doganore dhe zbatimi i çdo marrëveshjeje bilaterale apo rajonale në lidhje me detyrimet doganore). Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që KMP-ja të ofrojë të gjithë ndihmën, bashkëpunimin dhe informacionin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Kontraktuesi për të përgatitur projektin e rishikuar të TKP-së së pranuar.

3.B.2 Autoriteti Kontraktues do të regjistrojë pranimin e projektit të rishikuar të TKP-së së pranuar, duke siguruar që kryetari i KMP-së të nënshkruajë projektin e rishikuar të TKP-së së pranuar dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit (kur do të konsiderohet si "TKP e pranuar për vitin e 2-të [dhe sipas rastit për vitin e 3-të*]). Autoriteti Kontraktues nuk duhet të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme pranimin apo të vonojë pranimin e projektit të rishikuar të TKP-së së pranuar. Nëse

kryetari i KMP-së nuk e njofton Kontraktuesin me shkrim për refuzimin e projektit të rishikuar të TKP-së së pranuar (me një shpjegim të detajuar mbi arsyen(et) e refuzimit) brenda një afati 10-ditor pas marrjes nga kryetari i KMP-së të projektit të rishikuar të TKP-së së pranuar, do të konsiderohet si i pranuar nga Autoriteti Kontraktues për çdo qëllim. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me pranimin apo refuzimin e projektit të rishikuar të TKP-së së pranuar, do të zgjidhet në përputhje me nenin 10 të kontratës.

3.B.3 Në rastin kur projekti i rishikuar i TKP-së së pranuar nuk është nënshkruar nga palët apo konsideruar i pranuar nga palët në përputhje me paragrafin 3.B.2 më sipër, brenda një muaji pas vitit të parë [ose sipas rastit, pas vitit të dytë*] nga data e fillimit të shërbimeve për çdolloj arsye (duke përfshirë, por pa u kufizuar në të, si pasojë e një vendimi të lënë pezull për mosmarrëveshje në përputhje me nenin 10 të kontratës, Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë më të drejtë të zbresë ZAMS-të, ZMP-të apo ZMP-të nga çdo pagesë mujore Kontraktuesit, e cila do të bëhet për t'u paguar plotësisht Kontraktuesit mbi një bazë mujore, pavarësisht dispozitave të tjera të kontratës. Në rrethana të tilla, ZMP-të, ZAMS-të dhe ZMP-të e para mujore përkatëse do të bëhen për t'ia paguar Kontraktuesit 1 muaj pas vitit të parë [ose sipas rastit, pas vitit të dytë*] nga data e fillimit të shërbimit dhe Kontraktuesi do të ketë të drejtën të faturojë Autoritetin Kontraktues për të gjitha ZMP-të, ZAMS-të dhe ZMP-të në vazhdim deri në datën kur projekti i rishikuar i TKP-së së pranuar të jetë nënshkruar nga të dyja palët, këto fatura do të bëhen për t'u paguar brenda 30 ditëve nga data e faturës(ave) përkatëse të marra nga Autoriteti Kontraktues.

4. Rishikimet e të ardhurave vjetore viti i 1-rë dhe viti i 2-të [dhe viti i 3-të *]

4.1 Bilanci i ndonjërës prej zbritjeve ose pjesëve të zbritjeve që nuk i janë paguar Kontraktuesit sipas paragrafit 2 më sipër (duke përfshirë shumat që janë objekt i mosmarrëveshjes sipas procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (neni 10) ose ndryshe) për vitin e 1-rë dhe vitin e 2-të [dhe vitin e 3-të*], secila do të mbahet nga Autoriteti Kontraktues në pritje të rishikimit vjetor të pjesës I të TKP-së së pranuar (pra, të rritjes vjetore të të ardhurave të përgjithshme të mbledhura nga administrata tatimore nga baza ekzistuese, e cila do të mbahet në kuadër të rishikimit të TKP-së së pranuar tremujore në fund të vitit I (V1/T4) dhe viti e 2-të (V2/T4) [dhe viti i 3-të (V3/T4)*] (rishikimi i të ardhurave vjetore). Nëse RVA-ja është e barabartë apo e tejkalon përqindjen e synuar, të parashikuara në pjesën I të TKP-ve të pranuara, atëherë, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kontratës (duke përfshirë, por pa u kufizuar në nenin 2), bilanci i përgjithshëm agregat i mbetur i mbajtjeve (për aq sa ruhet tashmë nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk i paguhet Kontraktuesit sipas paragrafit 2) do të maturohet dhe të paguhet nga Autoriteti Kontraktues te Kontraktuesi sipas nenit 4.3 vijues. Në rastin kur kontrata përfundohet për çfarëdolloj arsye, sipas nenit 2.7 të kontratës, përpara përfundimit të vitit të 1-rë, viti i 2-të [ose viti i 3-të*], atëherë pavarësisht këtij përfundimi, rishikimi i të ardhurave vjetore në fund të vitit në të cilin ndodh përfundimi, do të vazhdojë të kryhet për qëllim të paragrafit 4.

4.2 Përpara çdo rishikimi vjetor të të ardhurave, Kontraktuesi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë kryetarit të KMP-së një raport me shkrim, i cili do të llogarisë RVA-në për vitin paraardhës dhe do të konfirmojë nëse RVA-ja është e barabartë ose tejkalon përqindjen e përcaktuar në TKP-në e pranuar (pjesa I) (raporti vjetor i rishikimit të të ardhurave). [Raporti vjetor i rishikimit të të ardhurave në fund të vitit të 1-rë llogarit RVA-në për vitin e 1-rë. Raporti vjetor i rishikimit të të ardhurave në fund të vitit të 2-të llogarit RVA-në për vitin e 2-të. Raporti vjetor i rishikimit të të ardhurave në fund të vitit të 3-të do të llogarisë RMVA-në për vitin e 3-të*.] Çdo raport vjetor i rishikimit të të ardhurave do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit dhe nëse RVA-ja tejkalon përqindjen e përcaktuar në TKP-në e pranuar (pjesa I), duhet të shoqërohet me një faturë përkatëse nga Kontraktuesi në shumën e bilancit total të agreguar të zbritjeve të papaguara për periudhën ose periudhat përkatëse.

4.3 Në lidhje me çdo rishikim vjetor të të ardhurave, nëse RVA-ja është e barabartë ose tejkalon përqindjen e përcaktuar në TKP-në e pranuar (pjesa I), atëherë Autoriteti Kontraktues ka

detyrimin që të pranojë raportin vjetor të rishikimit të të ardhurave duke bërë të mundur që kryetari i KMP-së të nënshkruajë raportin vjetor të rishikimit të të ardhurave dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit brenda një afati 20-ditor nga marrja prej kryetarit të KMP-së të raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave. Nëse kryetari i KMP-së nuk njofton me shkrim Kontraktuesin për refuzimin e raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda një periudhe prej 20 ditësh pas marrjes së raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave nga ana e kryetarit të KMP-së, ajo do të konsiderohet për të gjitha qëllimet si e pranuar nga Autoriteti Kontraktues. Me pranimin konkret ose të nënkuptuar të raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave në përputhje me këtë paragraf 4.3 (ose në rast mosmarrëveshje, atëherë në datën e vendimit të arbitrazhit në favor të Kontraktuesit në përputhje me nenin 10 të kontratës), mbetja e përgjithshme agregate e zbritjes(ve) për periudhën përkatëse do të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme për Kontraktuesin në përputhje me faturën përkatëse të Kontraktuesit brenda 30 ditëve nga data e faturës përkatëse e Kontraktuesit.

4.4 Çdo refuzim nga kryetari i KMP-së i raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave (pjesërisht ose në tërësi) duhet t'i komunikohet Kontraktuesit me shkrim (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda një afati 20-ditor nga data e marrjes prej kryetarit të KMP-së të raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave. Në rast refuzimi, Kontraktuesi ka të drejtë të ndryshojë raportin vjetor të rishikimit të të ardhurave dhe ta dorëzojë atë rishtazi te kryetari i KMP-së për një përsëritje të procedurës së rishikimit të parashikuar në paragrafët 4.2 dhe 4.3. Çdo mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me raportin vjetor të rishikimit të të ardhurave ose pranimin apo refuzimin e raportit vjetor të rishikimit të të ardhurave do të zgjidhet në përputhje me nenin 10 të kontratës.

5. Rishikimet vjetore të kontratës viti i 1-rë dhe viti i 2-të [dhe viti i 3-të*]

5.1 Në fund të vitit të 1-rë dhe vitit të 2-të [dhe viti i 3-të*], KMP-ja do të kryejë një rishikim të shërbimeve dhe kontratës (rishikimi vjetor i kontratës), i cili do të konsistojë në një rishikim, nëse (ose deri në çfarë mase) Kontraktuesi i ka arritur TPK-të në pjesën IV të TKP-ve të pranuara. Rishikimi vjetor i kontratës do të kryhet si pjesë e rishikimit të TKP-së së pranuar në fund të vitit I (V1/T4), vitit të 2-të (V2/T4) [dhe vitit të 3-të (V3/T4)*].

5.2 Përpara rishikimit vjetor të kontratës, Kontraktuesi duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë kryetarit të KMP-së një raport me shkrim, i cili do të konfirmojë nëse (ose deri në çfarë mase) Kontraktuesi ka arritur TKP-të e pranuara (pjesa IV) në vitin paraardhës dhe nëse jo (qoftë tërësisht ose pjesërisht në lidhje me ndonjë nga TKP-të e pranuara (pjesa IV), arsyet pse TKP-të e pranuara (pjesa IV) nuk kanë qenë të arritura (qoftë tërësisht ose pjesërisht) (raporti vjetor i rishikimit të kontratës). Autoriteti Kontraktues do dhe do të sigurojë që KMP-ja të ofrojë të gjithë ndihmën, bashkëpunimin dhe informimin që kërkohet nga Kontraktuesi, në mënyrë të arsyeshme të përgatisë raportet vjetore të rishikimit të kontratës. Raportet vjetore të rishikimit të kontratës do të firmosen nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit.

5.3 Në një datë të rënë dakord midis palëve brenda afatit 20-ditor të përmendur në paragrafin 2.1 në lidhje me rishikimin e TKP-së së pranuar tremujore përkatëse, KMP-ja do të takohet për të shqyrtuar dhe diskutuar raportin vjetor të rishikimit të kontratës. Nëse si rezultat i ndonjërit, vrojtimet e KMP-së, ndryshimet në raportin vjetor të rishikimit të kontratës janë të nevojshme, Kontraktuesi do të marrë parasysh këto vërejtje në përgatitjen e një varianti përfundimtar të raportit vjetor të rishikimit të kontratës, i cili duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i Kontraktuesit dhe t'i ridorëzohet kryetarit të KMP-së.

5.4 Në qoftë se Kontraktuesi ka arritur të gjitha ose pjesë të ndonjë prej TKP-ve të pranuara (pjesa IV), ose në qoftë se çdo mungesë nga ana e Kontraktuesit për të arritur të gjitha ose ndonjë pjesë të TKP-ve të pranuara (pjesa IV) është për shkak të një arsyeje apo shkaqe të forcës madhore, ose çdo mungesë për çfarëdo arsye nga ana e Autoritetit Kontraktues për të përmbushur cilindo nga detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, atëherë Autoriteti Kontraktues do të pranojë raportin vjetor të rishikimit të kontratës, duke bërë të mundur që kryetari i KMP-së të nënshkruajë raportin vjetor të rishikimit të kontratës dhe t'ia dorëzojë atë Kontraktuesit. Nëse

kryetari i KMP-së nuk njofton Kontraktuesin për refuzimin e raportit vjetor të rishikimit të kontratës (me një shpjegim të detajuar të arsyes(eve) të refuzimit) brenda një periudhe prej 30 ditësh pas pranimit të raportit vjetor të rishikimit të kontratës nga kryetari i KMP-së, ai do të konsiderohet për të gjitha qëllimet i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

5.5 Përfundimet dhe rekomandimet e rishikimit vjetor të kontratës në vitin e 1-rë dhe vitin e 2-të do të merren në konsideratë nga Kontraktuesi në ofrimin e shërbimeve në vitin në vazhdim.

6. Dispozita të përgjithshme

6.1 Autoriteti Kontraktues do dhe do të sigurojë që KMP-ja të ofrojë të gjithë ndihmën, bashkëpunimin dhe informimin që kërkohet nga Kontraktuesi në mënyrë të arsyeshme për të përgatitur të gjitha raportet tremujore të rishikimit të TKP-ve të pranuara, raportet vjetore të rishikimit të të ardhurave ose raportet vjetore të rishikimit të kontratës.

6.2 Autoriteti Kontraktues nuk do të ndalë apo vonojë në mënyrë të paarsyeshme pranimin e ndonjë prej raporteve tremujore të rishikimit të TKP-ve të pranuara, raporteve vjetore të rishikimit të të ardhurave ose raporteve vjetore të rishikimit të kontratës.

6.3 Për shmangien e çdo dyshimi, ky seksion i shtojcës C parashikon të drejtat e vetme dhe ekskluzive të Autoritetit Kontraktues të zhdëmtimit në lidhje me rrethanat në të cilat Kontraktuesi nuk ka arritur një apo disa prej TKP-ve të pranuara. Pa cenuar rastin specifik të "Raportit të rishikimit të TKP-ve të pranuara për vitin I/T4" të përmendur në nenin 2.7.1 (e), një mangësi e Kontraktuesit për të arritur një TKP të pranuar nuk përbën mangësi në përmbushjen e detyrimeve të Kontraktuesit sipas kontratës sipas nenit 2.7.1 (a).

6.4 Nëse Autoriteti Kontraktues kundërshton ndonjë shumë të përcaktuar në ndonjë faturë të përmendur në këtë seksion 2, Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë pjesën e pakundërshtuar brenda periudhës kohore të specifikuar për pagesën dhe palët do të bëjnë të pamundurën për të zgjidhur në mirëbesim të gjitha shumat e kundërshtuara në përputhje me nenin 10 të kontratës (zgjidhja e mosmarrëveshjeve). Në rast se mosmarrëveshja është zgjidhur në favor të Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë menjëherë shumën e kundërshtuar dhe do të paguhet interes mbi shumën e kundërshtuar në përputhje me nenin 6.1.6 të kontratës. Në rast se mosmarrëveshja është zgjidhur në favor të Autoritetit Kontraktues, Kontraktuesi duhet t'i lëshojë Autoritetit Kontraktues një notë kredie në lidhje me shumën e kundërshtuar.

6.5 *Çdo referencë në vitin e 3-të i referohet rastit të dhënies nga Autoriteti Kontraktues të njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës Kontraktuesit në përputhje me nenin 2.3.2 të kontratës.

6.6 Për shmangien e çdo dyshimi, të drejtat e Kontraktuesit për t'u paguar dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues për të paguar zbritjet e përcaktuara në shtojcën C, do të përbëjnë të drejta dhe detyrime shtesë të palëve sipas kushteve të parashikuara në nenin 2.7.3 të kontratës.

SEKSIONI 3
TABELA E RISHIKIMEVE TREMUJORE TË TKP-ve TË PRANUARA

Rishikim tremujor	**Pjesa I – Tregues kryesorë bazuar mbi të ardhurat**	**Pjesa II – Performancë bazuar mbi tregues të vazhdimësisë**	**Pjesa III – Tregues bazuar mbi pragjet**	**Pjesa IV – Rishikimi vjetor i treguesve të kontratës**
V1/T1				
V1/T2		√	√	
V1/T3		√		

V1/T4	√	√	√	√ + RVA V1 Rishikimi vjetor i të ardhurave
V2/T1		√		
V2/T2		√	√	
V2/T3		√		
V2/T4	√	√	√	√ + RVA V2: Rishikimi vjetor i të ardhurave
V3/T1*		√		
V3/T2*		√	√	
V3/T3*		√		
V3/T4*	√	√	√	√ + RMVA, V3: Rishikimi vjetor i të ardhurave

* Çdo referencë në vitin e 3-të i referohet rastit të dhënies nga Autoriteti Kontraktues të njoftimit për zgjatjen e afatit të kontratës, Kontraktuesit në përputhje me nenin 2.3.2 të kontratës.

SHTOJCA D
MODELI I LETRËS SË KONFIRMUAR TË GATSHME TË KREDISË NË FAVOR TË KONTRAKTUESIT (SHËRBIMET)

MT700	LËSHIMI I NJË KREDIE DOKUMENTARE
DËRGUESI	[Kodi *SWIFT i bankës lëshuese*]
MARRËSI	[SWIFT KODI I BANKËS KONFIRMUESE NË LONDËR]
27: SEKUENCA E TOTALIT	1/1
40A: FORMAT E KREDISË DOKUMENTARE	GARANCI BANKARE
20: DATA E KREDISË DOKUMENTARE	[ ]
31C: DATA E LËSHIMIT	[VVMMDD]
40E: RREGULLAT E ZBATUESHME	VERSIONI I FUNDIT I UCP600
31D: DATA DHE VENDI I SKADENCËS	[VVMMDD], [Kodi SWIFT i bankës konfirmuese në Londër]* Data e fillimit të shërbimeve + 24 muaj+6 muaj
50: APLIKANTI	QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE TIRANË SHQIPËRI
59: PËRFITUESI	CROWN AGENTS LIMITED ST NICHOLAS HOUSE ST NICHOLAS ROAD SUTTON SURREY SM1 1EL

	UNITED KINGDOM
32B: KODI I MONEDHËS DHE SHUMA CURRENCY CODE AND AMOUNT	EUR *1,052,280*
41A: E DISPONUESHME ME,..NGA..BIC	[Kodi SWIFT i bankës konfirmuese në Londër] [Emri dhe adresa e bankës konfirmuese në Londër] ME PAGESË
45A: PËRSHKRIMI I MALLRAVE/SHËRBIMEVE	KONTRATA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË REFORMËS SË DOGANAVE SHQIPTARE PËR TË OFRUAR SHËRBIME PËR TË ASISTUAR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NDËRMARRJEN E REFORMËS TË ADMINISTRATËS SHQIPTARE TË DOGANAVE PËR TË PËRMIRËSUAR PERFORMANCËN E TIJ, PËR TË RRITUR TË ARDHURAT DHE PËR TË REDUKTUAR KORRUPSIONIN SIPAS KONTRATËS [ ], DATË [ ]
46A: DOKUMENTET E KËRKUARA	1. KOPJE E FATURËS TREGTARE E MARKUAR SI "PAPAGUAR" 2. NJË KËRKESË E SHKRUAR, E LËSHUAR NGA PËRFITUESI, QË DËSHMON SE APLIKUESI ËSHTË NË SHKELJE TË DETYRIMIT(EVE) TË TIJ SIPAS KONTRATËS NR. [ ], DATË [ ] PËR ARSYE SE NUK KA PAGUAR FATURËN NR. [ ] PËR [ ] EURO BRENDA 30 DITËSH, DATA E FATURËS, E CILA MBETET E PAPAGUAR. NJË KOPJE E FATURËS SË PAPAGUAR BASHKËNGJITET KËTU
47A: KUSHTE SHTESË	1. LETRA E GATSHME E KREDITIT DO TË REDUKTOHET NGA ÇDO PAGESË E BËRË NGA NE SI REZULTAT I NJË KËRKESE 2. KJO LETËR E GATSHME KREDITI DO T'U NËNSHTROHET LIGJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE JURIDIKSIONI I ZGJEDHUR ËSHTË TIRANA, SHQIPËRI
71B: SHPENZIME	TË GJITHA SHPENZIMET JASHTË DHE BRENDA SHQIPËRISË (PËRFSHIRË SHPENZIMET E KONFIRMIMIT) JANË PËR LLOGARI TË APLIKANTIT
48: PERIUDHA PËR PARAQITJEN	NË ÇDO KOHË BRENDA VLEFSHMËRISË SË KREDISË
49: UDHËZIMET E KONFIRMIMIT	KONFIRMO
78: UDHËZIMET PËR PAYG/ACCPTG/NEGOTG BANK	JU JENI TË AUTORIZUAR TË KRYENI PAGESËN PËR PARAQITJEN(T) E PËRPUTHSHME, VLERËSONI TRI DITË PUNE NË MBRETËRINË E BASHKUAR NGA MOMENTI QË ZBULONI SE PARAQITJA NË FJALË ËSHTË E RREGULLT DOKUMENTET DO TË DËRGOHEN ME SHËRBIMIN POSTAR TE NE [ADRESA E BANKËS

	LËSHUESE]
57A: KËSHILLË PËRMES BANKËS	CRASGB2L (CROWN AGENTS BANK)
72: INFORMACIONI NGA DËRGUESI TE MARRËSI	

SHTOJCA E
PËRSHKRIMI I PUNËS SË KONTRAKTUESIT

1.1 Të përgjithshme

Objekti i veprimtarisë së programit do të mbulojë tri fusha të veçanta, por të ndërlidhura:

i) Efektivitetin operacional të doganave;

ii) Zhvillimin e burimeve njerëzore;

iii) Antikorrupsionin.

Ky nen shpjegon sesi Kontraktuesi do të prekë secilën nga këto fusha, çfarë veprimesh do të ndërmerren dhe rezultatet e pritura.

Plani i Zbatimit të Programit (PZP) të Kontraktuesit do të zhvillohet gjatë fazës së mobilizimit të kontratës (muaji 1-2) dhe në përputhje me nevojat e deklaruara dhe të njohura të qeverisë së Shqipërisë, dhe do të mbajë parasysh prioritetet përkatëse në çdo fushë. PZP-ja do të përfshijë kësisoj elementet kryesore në vijim:

- fokus në rritjen e niveleve të mbledhjes së të ardhurave;
- fokus në reduktimin e mundësive për korrupsion;
- kryerjen e veprimeve të veçanta sipas kërkesave specifike të administratës doganore;
- integrimin e veprimeve përgjatë fushave të veprimtarisë për të maksimizuar impaktin.

PZP-ja do të përfundohet, gjithashtu, në konsultim me palë të tjera të interesuara, duke përfshirë projektet ECD dhe IPA, për të shmangur dublikimet, dhe kur është e mundur, të rrisë mundësitë për bashkërendim.

1.2 Eficienca e operacioneve doganore

Kontraktuesi do të ndërmarrë një varg veprimesh në këtë fushë, të cilat do të mbështesin të tërë punën e bërë nga njësitë vepruese për mbledhjen e të ardhurave dhe, gjithashtu, do të mbështesë zhvillimin afatgjatë të kapacitetit të Administratës Doganore.

Me qëllim për të rritur efektivitetin në punës, Kontraktuesi:

- do të rishikojë dhe përmirësojë planifikimin, metodologjinë dhe vlerësimin e operacioneve doganore (ndalime, kontroll, inspektim);
- do të mobilizojë 8 grupe operacionale doganore, që do të ketë në përbërje personel nga doganat shqiptare dhe këshilltarë nga Crown Agents;
- do të mobilizojë grupet në pikat doganore në të gjithë vendin për të vlerësuar rrezikun e mbledhjes së të ardhurave, do të synojë të ardhurat në rrezik, si dhe të sensibilizojë tregtarët në drejtim të përshtatjes me rregullat;
- do të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e profileve të riskut mbi bazën e informacionit të përfituar nga grupet operacionale, të fokusuar në mallrat me vlerë dhe rrezik të lartë, në mënyrë që të rritet ndikimi në mbledhjen e të ardhurave, lufta kundër trafiqeve të paligjshme dhe çështjeve që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik.

1.3 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore do të synojë të krijojë një Administratë Doganore me personel profesional, të trajnuar, që punon me një nivel të lartë integriteti. Në mbështetje të kësaj, Kontraktuesi do të:

- shqyrtojë dhe ofrojë një sistem për matjen e perfomancës në punë dhe lidhjen e sistemit të vlerësimit me sistemin e karrierës;
- rishikimi i përshkrimeve të vendeve të punës për çdo pozicion;

- përshtatja e trajnimeve me vendin e punës për rritjen e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë.

Veprimtaritë e Kontraktuesit në këtë fushë do ta ndihmojnë Administratën Doganore për të zhvilluar kapacitetin e saj të brendshëm për të ndërmarrë kontrolle efektive, të bazuara në risk, në një mënyrë konsistente dhe transparente dhe me nivele të rritura integriteti.

1.4 Antikorrupsioni

Kontraktuesi do të ndërmarrë një qasje dyrrugëshe për t'iu përgjigjur korrupsionit. Elementi i parë do të synojë të arrijë një reduktim të shpejtë të korrupsionit brenda Administratës Doganore. Si hap i parë:

- do të mbështesë prezantimin e Kodit të ri të Etikës për të gjithë personelin doganor;
- do të nxjerrë njoftime publike, që njoftojnë Kodin e Etikës në të gjitha vendndodhjet e doganave;
- do të kryejmë trajnime dhe do të rrisim sensibilizimin e personelit doganor në drejtim të zbatimit të Kodit Etik;
- do të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit të punonjësve të Administratës Doganore për rrezikun e korrupsionit, rëndësinë e denoncimit të tij, si dhe masat ndëshkuese antikorrupsion;
- do të kryejë fushata sensibilizuese me biznesin dhe grupet e interesit për ndërgjegjësimin e luftës kundër korrupsionit dhe denoncimin e tij.

Njësitë vepruese do të monitorojnë më pas performancën e personelit të doganës kundrejt kodit të ri dhe do të raportojnë për çdo rast ku ai nuk është duke u zbatuar siç duhet. Ky ushtrim i monitorimit duhet të ketë një ndikim të menjëhershëm në nivelet e korrupsionit, duke qenë se do të rrisë "koston efektive korrupsionit". Mundësia e zbulimit duhet të jetë menjëherë më e lartë dhe pasojat do të jenë më serioze.

Në afat të gjatë, ne do të mbështesim zhvillimin e mëtejshëm të standardeve etike brenda doganave dhe ne:

- do të mbështesim zhvillimin e procedurave më të forta për hetimin e brendshëm;
- do të mbështesim futjen e një sistemi denoncimi (*whistleblower*) për raportimin e korrupsionit dhe praktikat e gabuara brenda administratës doganore.

SHTOJCA F
MODELI I GARANCISË SË PARADHËNIES NË FAVOR TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Kontraktuesi është i detyruar t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një paradhënie garancie bankare në formën në vazhdim dhe për shumën në vijim:

Për:
Qeveria e Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë
Shqipëri

Të nderuar,

Re: Nr. i garancisë bankare:

Për parapagesën e Crown Agents, sipas Kontratës për Implementimin e Programit të Reformës së Doganës Shqiptare

1. Ne, Crown Agents Bank Limited, një bankë e Mbretërisë së Bashkuar në St Nicholas House, St Nicholas Road, Sutton, Surrey SM1 1EL, Mbretëria e Bashkuar, jemi njoftuar që më [ ] 2013, është nënshkruar një kontratë midis jush, qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që vepron përmes Këshillit të Ministrave si Autoritet Kontraktues dhe shoqërisë Crown Agents Limited, Mbretëri e Bashkuar], si Kontraktues, për "Kontratën për Zbatimin e Programit të Reformës së Doganave Shqiptare" (kontrata) për një shumë totale prej [ ] € ([…….] euro).

2. Sipas kushteve të kontratës, Kontraktuesi duhet të paraqesë një garanci bankare (Garancia) për përmbushjen në favorin tuaj për shumën prej [ ]€ [.....] (euro), e cila përfaqëson 10% të vlerës së kontratës. Për sa i përket sa më sipër dhe me urdhër të Kontraktuesit, në Crown Agents Bank Limited marrin përsipër në mënyrë të parevokueshme dhe pavarësisht nga vlefshmëria e kontratës më sipër, detyrimin për t'ju paguar çdo shumë në maksimumin prej [] € ([.....] euro) pas pranimit të kërkesës suaj për pagesë të nënshkruar dhe vulosur, duke deklaruar se Crown Agents Limited nuk ka përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimet e saj sipas kontratës. Përgjegjësisë sonë në lidhje me këtë Garanci do t'i zbritet automatikisht shuma e çdo pagese të bërë në lidhje me këtë Garanci. Kërkesa juaj me shkrim për pagesë duhet të paraqitet te ne përmes ndërmjetësimit të zyrës qendrore të bankës, i cili është ofruesi juaj i shërbimit dhe i cili duhet të vërtetojë se nënshkrimet janë të vërteta dhe ju detyrojnë ju në bazë të ligjit në fuqi.

3. Shuma e kësaj Garancie do të zvogëlohet automatikisht pas një periudhe 24-mujore (njëzetekatërmujore) nga data e fillimit të shërbimeve të kontratës me një shumë prej [ ]€ [.....] (euro) në muaj deri sa vlera e kësaj garancie është reduktuar në zero.

4. Kjo garanci do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së pagesës së paradhënies prej [ ]€ [ ] (euro) nga Kontraktuesi në përputhje me nenet 6.1.2 dhe 6.1. të kontratës dhe do të mbesë e vlefshme deri në [datë e përfundimit të kontratës**] dhe do të përfundojë plotësisht dhe automatikisht në rast se kërkesa juaj dorëzuar në përputhje me kërkesat e mësipërme nuk është marrë Crown Agents Bank Limited deri në fund të ditës së punës ** më [datë], ose, nëse kjo nuk është një ditë pune për bankën, deri në fund të ditës së punës, e cila është dita e parë vijuese e punës për bankën, domethënë nga ora 15.30 GMT). Pas kësaj date, detyrimi ynë do të jetë i pavlefshëm, pavarësisht nëse origjinali i Garancisë na është dërguar mbrapsht apo jo.

Garancia mund të lëshohet përpara përfundimit të vlefshmërisë dhe vetëm pasi origjinali i Garancisë i është kthyer mbrapsht Crown Agents Bank Limited.

5. Kjo Garanci u nënshtrohet Rregullave Uniforme për Kërkimin e Garancive (*Uniform Rules for Demand Guarantees)*, publikimi i ICC No.758.

Nënshkruar në Sutton në [ ] i [ ] 2013.

I autorizuar rregullisht

Në emër dhe për llogari të Agents Bank Limited

Nënshkrimet:

SHTOJCA H

LISTA E PERSONELIT TË HUAJ QË DO TË PUNËSOHEN SIPAS KONTRATËS

Titulli	**Emri**
Drejtor për Doganat dhe Lehtësimin e Tregtisë	Stephen William Brady
Drejtor Programi	David Martin Smith
Administrator Operacionesh	Graham Alexander Main
Zv/administrator Operacionesh	Kevin Atkinson
Këshilltar Operacionesh	Gordon Henri Bines
Këshilltar Operacionesh	Keith Dunmore
Këshilltar Politikash Doganore	David Norley
Këshilltar Antikorrupsion	Andrew John Laird-Robertson
Administrator Programi	Kevin David Lewis
Këshilltar Operacionesh	Lea Bruce Nolan
Këshilltar Operacionesh	Jarmo Juhani Tukia
Këshilltar Operacionesh	Artus Madzuliz
Këshilltar Operacionesh	Bill Martin Elliason
Këshilltar Operacionesh	Jacek Mariusz Jankowski
Këshilltar Operacionesh	John Dodds

Këshilltar Operacionesh	Julija Amelina
Këshilltar Burime Njerëzore	Gertie Merete Rosenberg

Ndryshimet e personelit miratohen nga KMP-ja brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

SHTOJCA I
MODELI I TREGUESVE KRYESORË TË PERFORMANCËS TË PRANUAR (TKP-të E PRANUARA)
[TË BIHET DAKORD NË PËRPUTHJE ME PARAGRAFIN 2 TË SHTOJCËS C TË KONTRATËS]

1	2	3	4	5	6	7
%			**Zona e punës**	**Treguesi**	**Përshkrimi**	**Matja**
Pjesa I – Tregues kryesorë bazuar mbi të ardhurat						
10%	10%	1	E përgjithshme	Nivelet e mbledhjes së të ardhurave	Rritje nga viti në vit në të ardhurat e mbledhura nga Administrata Doganore e shprehur si përqindje e PBB-së së Shqipërisë, duke përdorur si bazë matjet e pavarura të PBB-si që bën FMN-ja.	Një rritje prej 1% në vit në nivelin e të ardhurave doganore të mbledhura nga Administrata Doganore, shprehur si përqindje e PBB-së.
Pjesa II – Tregues vazhdimësie bazuar mbi performancën						
10%	2%	2.1	Veprimet doganore	Zbulimi i shkeljeve doganore	Ndërhyrje të drejtpërdrejta nga njësia vepruese	75 në muaj: Numri i zbulimeve, i bërë nga njësitë vepruese për muaj
	2%	2.2	Veprimet doganore	Nivel i rritur i ndërhyrjes	Kërkime të plota të ndërmarra nga njësitë vepruese	250: Numri i inspektimeve të plota, i ndërmarrë nga njësitë vepruese për çdo muaj
	2%	2.3	Veprimet doganore	Nivel i rritur i ndërhyrjes	Kërkime të pjesshme të ndërmarra nga njësitë vepruese	175: Numri i inspektimeve të pjesshme, të ndërmarra nga njësitë vepruese për çdo muaj
	2%	2.4	Veprimet doganore	Profesionalizmi në rritje	Numri i lokacioneve të vizituara nga njësitë vepruese	10: Numri i lokacioneve të vizituara çdo muaj
	2%	2.5	Veprimet doganore	Vlera e identifikuar e humbjes së të ardhurave	Vlera e identifikuar e humbjes së të ardhurave të mundshme si	*Për të rënë dakord brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, mbi bazën e procesit të*

					rezultat i ndërhyrjeve vepruese	*testimit të riskut paraprak.*
Pjesa III – Tregues bazuar mbi pragjet						
5%	1%	3.1	Veprimet doganore	Organizimi i njësive vepruese	Krijimi, pajisja dhe organizimi i 8 njësive vepruese	Krijimi, pajisja dhe organizimi i 8 njësive vepruese
	1%	3.2	Menaxhimi i riskut	Zhvillimi i profileve të riskut	Identifikimi, kuantifikimi dhe rishikimi i profileve ekzistuese të riskut	Identifikimi, kuantifikimi dhe rishikimi i profileve ekzistuese të riskut. - numri i profileve të propozuara (të reja dhe të rishikuara), në rritje; - realizimi i analizës së *feedback* të profileve; - numri i rasteve me shkelje në rritje.
	1%	3.3	Burimet njerëzore (HR)	Profesionalizmi në rritje	Rishikimi i kompetencave të vendeve të punës ekzistuese	Rishikimi i kompetencave të vendeve ekzistuese të punës
	1%	3.4	Antikorrupsion	Nivele më të larta integriteti	Përgatitja e Kodit të ri të Etikës	Përgatitja e Kodit të ri të Etikës
	1%	3.5	Antikorrupsion	Nivele më të larta integriteti	Zhvillimi i njoftimeve publike mbi Kodin e ri të Etikës	Zhvillimi i njoftimeve publike mbi Kodin e ri të Etikës
Pjesa IV – Tregues rishikimi vjetor						
75%	Rishikim njëvjeçar	4.1	I përgjithshëm	Vlerësim në lidhje me doganat dhe tregtinë, siç parashikohen në raportet *Doing Business* të Bankës Botërore		
		4.2	Operacione	Mbështetja dhe vazhdimi i punës nga njësitë vepruese për të rritur mbledhjen e të		

				ardhurave		
		4.3	HR	Mbështetja e profesionalizimit të Administratës Doganore duke rekomanduar kriteret për stafin		
		4.4	Antikorrupsion	Nivelet e korrupsionit aktual dhe të perceptuar brenda sistemit të mbledhjes së të ardhurave, përfshirë Indeksin e Perceptimit TI të korrupsionit		

Miratuar dhe pranuar nga:

----------	----------
Përfaqësuesi i autorizuar në emër dhe për llogari të Crown Agents Limited (Kontraktuesi)	Përfaqësuesi i autorizuar në emër dhe për llogari të qeverisë së Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave) (Autoriteti Kontraktues)
DATË	

SHTOJCA K
MODELI I NJOFTIMIT PËR ZGJATJEN E KONTRATËS (VITI I 3-të)

[*Në letër me kokë të Autoritetit Kontraktues*]

[EMRI I KONTRAKTUESIT]
[ADRESA]

[DATA]

I nderuar zotëri,

Marrëveshja për Implementimin e Programit të Reformës në doganat shqiptare ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Crown Agents Limited, datë [ ] 2013 (kontrata): Njoftimi për zgjatjen e kontratës (viti i 3-të).

I referohemi kontratës të përmendur më sipër.

Ju lutemi të pranoni këtë letër si njoftim për t'ju informuar se Autoriteti Kontraktues po ushtron të drejtën e tij sipas nenit 2.3.2(i) të kontratës, për zgjatjen e kontratës për një periudhë 1-vjeçare (viti i 3-të).

Në këto kushte, afati i kontratës përfundon në [DATË].

Në përputhje me nenin 2.3.2(ii) të kontratës, kjo zgjatje për vitin e 3-të do të jetë objekt dhe do të kushtëzohet me marrjen nga ana e Kontraktuesit brenda 10 ditëve nga njoftimi për zgjatjen e kontratës (viti i 3-të), të një zgjatjeje të afatit të letrës së konfirmuar të transferueshme të gatshme të kredisë (për shërbimet) në datën e përfundimit të saj sipas pikës 2.1.1(e) deri në fund të vitit të 3+6 muaj (dhe në formatin e pranueshëm nga Kontraktuesi, pranim i cili t'i jetë konfirmuar me shkrim Autoritetit Kontraktues nga Kontraktuesi), lëshuar nga Banka _____, Shqipëri dhe e konfirmuar rregullisht Banka_____, Londër (emri i Bankës dhe i asaj konfirmuese në Londër do të dakordohet me shkrim nga palët).

Jeni të lutur të nënshkruani dhe të na dërgoni të nënshkruar kopjen e kësaj letre për të konfirmuar marrjen në dorëzim.

Mbetemi në pritje të përgjigjes suaj,
Sinqerisht,
.....

Në emër dhe për llogari të
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
Përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave
……..
Marrja konfirmohet
Në emër dhe për llogari të
Crown Agent Limited

SHTOJCA L
MODELI I LETRËS SË KONFIRMUAR E TË GATSHME TË KREDISË NË FAVOR TË KONTRAKTUESIT (AUTOMJETET)

MT700	LËSHIMI I NJË KREDIE DOKUMENTARE
DËRGUESI	[Kodi *SWIFT-i bankës lëshuese*]
MARRËSI	[SWIFT KODI I BANKËS KONFIRMUESE NË LONDËR]

27: SEKUENCA E TOTALIT	1/1
40A: FORMAT E KREDISË DOKUMENTARE	GARANCI BANKARE
20: DATA E KREDISË DOKUMENTARE	[ ]
31C: DATA E LËSHIMIT	[VVMMDD]
40E: RREGULLAT E ZBATUESHME	VERSIONI I FUNDIT I USP 600
31D: DATA DHE VENDI I SKADENCËS	[VVMMDD], [Kodi SWIFT i bankës konfirmuese në Londër]* Data e fillimit të shërbimeve + 3 muaj
50: APLIKANTI	QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE TIRANË SHQIPËRI
59: PËRFITUESI	CROWN AGENTS LIMITED ST NICHOLAS HOUSE ST NICHOLAS ROAD SUTTON SURREY SM1 1EL UNITED KINGDOM
32B: KODI I MONEDHËS DHE SHUMA CURRENCY CODE AND AMOUNT	400.000 euro (katërqind mijë euro)
41A: E DISPONUESHME ME,.. NGA.. BIC	[Kodi SWIFT e bankës konfirmuese në Londër] [Emri dhe adresa e bankës konfirmuese në Londër] ME PAGESË
45A: PËRSHKRIMI I MALLRAVE/SHËRBIMEVE	LIVRIMI DHE DORËZIMI I 10 (DHJETË) AUTOMJETEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË REFORMËS NË DOGANAT SHQIPTARE NR.___, DATË___
46A: DOKUMENTET E KËRKUARA	1. KOPJE E FATURËS TREGTARE E MARKUAR SI "E PAPAGUAR" 2. NJË KËRKESË E SHKRUAR, E LËSHUAR NGA PËRFITUESI, QË DËSHMON SE APLIKUESI ËSHTË NË SHKELJE TË DETYRIMIT(EVE) TË TIJ, SIPAS KONTRATËS NR. [ ], DATË [ ] PËR ARSYE SE NUK KA PAGUAR FATURËN NR. [ ] PËR [ ] EURO BRENDA 30 DITËSH NGA DATA E FATURËS, E CILA MBETET E PAPAGUAR. NJË KOPJE E FATURËS SË PAPAGUAR BASHKËNGJITET KËTU
47A: KUSHTE SHTESË	3. LETRA E GATSHME E KREDITIT DO TË REDUKTOHET NGA ÇDO PAGESË E BËRË NGA NE SI REZULTAT I NJË KËRKESE 4. KJO LETËR E GATSHME KREDITI DO T'U NËNSHTROHET LIGJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE JURIDIKSIONI I ZGJEDHUR ËSHTË TIRANA, SHQIPËRI
71B: SHPENZIME	TË GJITHA SHPENZIMET JASHTË DHE BRENDA SHQIPËRISË (PËRFSHIRË SHPENZIMET E KONFIRMIMIT) JANË PËR LLOGARI TË

	APLIKANTIT
48: PERIUDHA PËR PARAQITJEN	NË ÇDO KOHË BRENDA VLEFSHMËRISË SË KREDISË
49: UDHËZIMET E KONFIRMIMIT	KONFIRMO
78: UDHËZIMET PËR PAYG/ACCPTG/NEGOTG BANK	JU JENI TË AUTORIZUAR TË KRYENI PAGESËN PËR PARAQITJEN(T) E PËRPUTHSHME, VLERËSONI TRI DITË PUNE NË MBRETËRINË E BASHKUAR NGA MOMENTI QË ZBULONI SE PARAQITJA NË FJALË ËSHTË E RREGULLT DOKUMENTET DO TË DËRGOHEN ME SHËRBIMIN POSTAR TE NE [ADRESA E BANKËS LËSHUESE]
57A: KËSHILLË PËRMES BANKËS	CRASGB2L (CROWN AGENTS BANK)
72: INFORMACIONI NGA DËRGUESI TE MARRËSI	